



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaçica, Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit të UMIB-it
Prof. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 1323
Dt 06.10.2020

Në bazë të nenit 49 dhe në lidhje me nenin 122,123,129,130 dhe 131 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 30.9.2020, mori:

VENDIM

Për kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve themelore-bachelor për vitin akademik 2020/2021.

I

Studentët e Universitetit të Mitrovicës mund të regjistrojnë vitin vijues të studimeve nëse i plotësojnë këto kushte:

- a) Vitin e dytë të studimeve mund ta regjistrojnë ata studentë të cilët kanë fituar 70% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore të vitit të parë të studimeve.
- b) Përjashtimisht, studentët e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike-Drejtimi Inxhinieri Ekonomike mund ta regjistrojnë vitin e dytë me më së paku 7 (shtatë) provime të dhëna në vitin e parë.
- c) Vitin e tretë të studimeve mund ta regjistrojnë ata studentë të cilët i kanë fituar 40% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore të vitit të dytë të studimeve.
- d) Vitin e katërt të studimeve mund ta regjistrojnë ata studentë të cilët i kanë fituar 30% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore të vitit të tretë të studimeve.
- e) Përjashtimisht, për studentët e Fakultetit të Edukimit-Programi fillor, të cilët e kanë regjistruar vitin e tretë në vitin akademik 2019/2020, totali i kredive të të gjitha provimeve është 55 kredi. Rrjedhimisht, studentët e kësaj gjenerate, mund ta regjistrojnë vitin e katërt me 13 kredi (30%-5 kredi).

II

Studenti është i obliguar që në vitin pasardhës t'i japë paraprakisht provimet e mbetura nga viti paraprak e pastaj të fillojë dhënien e provimeve në vitin, në të cilin është i regjistruar.

III

1. Ndërrimi i programit të studimeve- i lejohe studentit që të fillojë program të ri të studimeve, nëse së paku 50% të provimeve, përkatësisht të kredive i ka dhënë me sukses gjatë programit të vjetër të studimeve dhe që pranohen në programin e ri të studimeve.
2. Studentit mund t'i lejohe që të regjistrohe në programin e ri të studimeve më së paku në vitin e dytë të studimeve.
3. Ndërrimi i programeve mund të lejohe deri në 5% nga numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në Degën përkatëse të Fakultetit.

IV

Ngjashëm me paragrafin e dytë dhe të tretë të pikës III të këtij vendimi, mund të lejohe edhe transferimi i studentëve nga Universitetet e tjera të akredituara në Universitetin e Mitrovicës. Përgjithësisht, transferimi i studentëve nga Universitetet e tjera të akredituara në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike të Universitetit të Mitrovicës mund të lejohe më së paku në vitin e dytë të studimeve, me më së paku 7 (shtatë) provime të dhëna në vitin e parë dhe që pranohen në programin e studimeve ku transferohen.

V

Studenti mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohe kohëzgjatja e studimeve për një apo dy vite. Vendimin e merr Këshilli i njësive akademike. Në rast se merret vendim pozitiv, studentin do ta ketë sërish statusin e studentit të rregullt.

VI

Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy viteve pasi studentin t'i ketë përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe, studentin duhet të japë provimin e diplomës që t'i përfundojë me sukses studimet.

Studentin që e ka tejkaluar kohën e paraparë për të përfunduar me sukses diplomën mund të paraqesë kërkesë te dekanin i njësive akademike për zgjatjen e kësaj periudhe edhe për një vit.

Studentin, i cili një vit pas përfundimit të semestrit të fundit nuk i përfundon studimet, sërish e regjistron vitin e studimeve me pagesë.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Dekanëve të njësive akademike;
3. Sekretarëve të fakulteteve;
4. Sekretarit të përgjithshëm;
5. Zyrtarit ligjor.

Prof. dr. Alush Musaj



Rektor i UMIB-it

